

Deloitte.
Audit

TETE Albania Tunnel & Mining Sha

**Raporti i Audituesit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**



PËRMBAJTJA:

	Faqe
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE GJITHËPËRSHIRËSE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO	6
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	7
SHËNIME SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE	8-41

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Aksionarëve dhe Drejtimit të Tete Albania Tunnel & Mining Sha,

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Tete Albania Tunnel & Mining Sha ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital neto dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe nga një përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datë 31 dhjetor 2019 si edhe të performancës së saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Bazat për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "*Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare*" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Pasiguri materiale në lidhje me Parimin e vijimësisë

Ne tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues nr. 2.4 të pasqyrave financiare duke theksuar se Shoqëria ka raportuar një humbje të akumuluar prej Lek 823,151,782 (31 dhjetor 2018: 385,325,173 Lek). Këto kushte, së bashku me çështjet të tjera të përshkuara në shënimin shpjegues nr. 2.4, tregojnë se ekziston një pasiguri materiale që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Opinioni ynë nuk është i modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen në Shënimin 28 - Vlerësimet Kritike të Kontabilitetit dhe Gjykime në Zbatimin e Politikave të Kontabilitetit të pasqyrave financiare, që përshkruan efektet e përfundimit të periudhës së Koncesionit për Shoqërinë. Opinioni ynë nuk është i modifikuar në lidhje me këtë çështje

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacione të tjera. Informacione të tjera përmbajnë informacione të dhëna në Raportin e Aktivitetit të Performancës dhe Raportin e Drejtimit të Brendshëm, të përgatitur nga Drejtimit në përputhje me Nenin 17 dhe 19 të Ligjit 25/2018, datë 19 Janar 2019 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", të ndryshuara, por nuk përmbajnë pasqyra financiare dhe raportin tonë të auditimit për këto pasqyra. Raporti i Aktivitetit të Performancës dhe Raporti i Drejtimit të Brendshëm pritet të jenë në dispozicion pas datës së raportit të auditimit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim konkluzione që japin siguri lidhur me këto informacione.

Informacione të tjera (vazhdim)

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më sipër kur të na vihen në dispozicion dhe, të vlerësojmë nëse këto informacione kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare apo me kuptueshmërinë që kemi marrë gjatë auditimit ose në rast se përmbajnë anomali materiale. Kur të lexojmë Raportin Vjetor, nëse ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë anomali materiale, atëherë, ne na kërkohet të raportojmë mbi këtë fakt palëve të ngarkuara me qeverisjen.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuadojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit së auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontroleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontroleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbledhjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë dhe shënimet shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë që të arrihet një paraqitje e drejtë

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Shoqërisë, ku përveç çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikur gjatë auditimit tonë.

Deloitte Audit Albania Shpk

Deloitte Audit Albania Shpk

Rruga Faik Konica, Ndërtesa nr. 6 Hyrja nr. 7, 1010,

Tiranë, Shqipëri

Numër unik i identifikimit të subjektit (NUIS): L41709002H

Auditues Ligjor
Partner i angazhimit
Enida Cara



Tiranë, Shqipëri
22 maj 2020

TETE Albania Tunnel & Mining Sha
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019

Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2019	Më 31 dhjetor 2018
Aktive			
Ndërtesa, makineri e pajisje	5	1,723,203,956	1,282,678,684
Aktivet afatgjata jo materiale	6	2,750,934	3,364,083
E drejta e perdorimit të aktiveve	7	20,557,006	-
Totali i aktiveve afatgjata		1,746,511,896	1,286,042,767
 Inventari	8	93,594,424	45,237,460
TVSH e arkëtueshme	9	485,294,127	240,325,139
Të ardhura të përlogaritura	10	111,559,120	65,113,089
Aktive të tjera	11	28,897,780	12,446,480
Parapagime për aksionerët	12	5,256,450	-
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	13	16,587,828	15,117,533
Totali i aktiveve afatshkurtra		741,189,729	378,239,701
Totali i aktiveve		2,487,701,625	1,664,282,468
 Kapitali dhe detyrimet			
Kapitali aksionar	14	44,000,000	44,000,000
Humbje të akumuluar		(823,151,782)	(385,325,173)
Totali i kapitalit		(779,151,782)	(341,325,173)
 Huatë	15	1,670,714,466	1,362,458,588
Detyrime për qiratë financiare	16	99,830,377	30,212,100
Detyrime tatimore të shtyra	17	-	1,217,387
Totali i detyrimeve afatgjata		1,770,544,843	1,393,888,075
 Llogari të pagueshme tregtare	18	487,001,810	286,185,242
Detyrime të tjera	19	31,976,750	27,955,991
Detyrime për qiratë financiare	16	115,636,745	17,744,366
Huatë	15	861,693,260	279,833,967
Total liabilities		1,496,308,564	611,719,566
Total liabilities and shareholders' equity		2,487,701,625	1,664,282,468

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në faqen 41, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare. .

TETE Albania Tunnel & Mining Sha**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhurat			
Të ardhurat	20	1,248,464,163	773,557,345
Të ardhura të tjera		466,884	57,345
Totali i të ardhurave		1,248,931,047	773,614,690
Expenses			
Shpenzime materialesh	21	(514,902,523)	(380,409,576)
Shpenzime operative	22	(334,019,200)	(205,507,667)
Shpenzime personeli	23	(323,475,947)	(207,262,507)
Amortizimi dhe zhvlerësimi	5,6	(190,383,733)	(100,223,661)
Shpenzime amortizimi – e drejta e përdorimit të aktiveve	7	(6,197,565)	-
Zhvlerësimi I aktiveve	5,6	(119,823,076)	-
Totali i shpenzimeve		(1,488,802,044)	(893,403,411)
Humbje operative		(239,870,997)	(119,788,721)
Fitim/(humbje) financiare			
Shpenzime interesi		(195,093,711)	(85,087,848)
Shpenzime të tjera financiare		(4,704,430)	(3,774,703)
Fitimet nga këmbimi i monedhave të huaja		625,142	31,096,142
Totali i humbjes financiare	24	(199,172,999)	(57,766,409)
Humbja para tatimit		(439,043,996)	(177,555,130)
Kreditim/(shpenzim) i tatim fitimit	17	1,217,387	(658,985)
Humbja neto për vitin		(437,826,609)	(178,214,115)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i humbjes gjithëpërfshirëse për vitin		(437,826,609)	(178,214,115)

Pasqyra e e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në faqen 41, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TETE Albania Tunnel & Mining Sha

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

	Kapitali aksionar	Humbjet e akumuluatra	Totali
Teprica më 1 janar 2018	44,000,000	(207,111,058)	(163,111,058)
Humbja neto e vitit	-	(178,214,115)	(178,214,115)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse	-	-	-
Totali i humbjes gjithpërfshirëse të vitit	-	(178,214,115)	(178,214,115)
Teprica më 31 dhjetor 2018	44,000,000	(385,325,173)	(341,325,173)
Humbja neto e vitit	-	(437,826,609)	(437,826,609)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse	-	-	-
Totali i humbjes gjithpërfshirëse të vitit	-	(437,826,609)	(437,826,609)
Teprica më 31 dhjetor 2019	44,000,000	(823,151,782)	(779,151,782)

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Bordi Drejtues i TETE Albania Tunnel & Mining Sha më 21 maj 2020 dhe u nënshkruan në emër të tyre nga:


 Eyup Batal
 Administrator



Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në faqen 41, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TETE Albania Tunnel & Mining Sha
Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(Të gjitha shumat janë të shprehura në Lek)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Flukse monetare nga aktiviteti shfrytëzues		
Humbja para tatimit	(439,043,996)	(177,555,130)
<i>Rregullime për:</i>		
Zhvlerësimin dhe amortizimin	190,383,733	100,223,661
Zhvlerësim i të drejtës për përdorimin e aktiveve	6,197,565	-
Zhvlerësim i aktiveve fikse	119,823,076	-
Shpenzime për interesa	194,095,898	116,360,821
Fitim nga përkthimi i monedhave të huaja	10,179	(32,715,511)
Mjete monetare neto gjeneruar/përdorur në aktivitetin shfrytëzues para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet	71,466,455	6,313,841
Rritje në inventar	(48,356,964)	(39,677,128)
Rritje në TVSH e arkëtueshme	(244,968,988)	(128,741,015)
Rritja në të ardhura të përlllogaritura	(46,446,031)	(69,371,501)
Rritje në aktive të tjera	(16,451,302)	(5,306,140)
Rritje në parapagime për palët e lidhura	(5,256,450)	-
Rritje në llogari të pagueshme tregtare	200,816,568	66,220,422
Rritje në detyrime të tjera	4,020,758	14,602,972
Interesat e paguara	(141,469,875)	(101,278,773)
Mjete monetare neto përdorur në aktivitetin shfrytëzues	(226,645,829)	(257,237,322)
Flukse monetare nga aktiviteti investues		
Blerje ndërtesa, makineri e pajisje	(519,535,808)	(310,254,756)
Mjete monetare neto përdorur në aktivitetin investues	(519,535,808)	(310,254,756)
Flukse monetare nga aktiviteti financues		
Disbursime nga huatë	2,007,247,553	1,412,060,289
Shlyerje të huave	(1,148,758,729)	(837,607,834)
Shlyerje të detyrimeve për qiratë financiare	(110,826,713)	(8,220,956)
Mjete monetare neto gjeneruar nga aktiviteti financues	747,662,111	566,231,499
(Rënia) / rritja neto në mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	1,480,474	(1,260,579)
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fillim të vitit	15,117,533	13,605,476
Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimit në mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	(10,179)	2,772,636
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fund të vitit	16,587,828	15,117,533

Pasqyra e flukseve monetare duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në faqen 41, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

TETE Albania Tunnel & Mining Sha ("Shoqëria") e filloi aktivitetin e saj në 2007 si shoqëri shërbimi në fushën minerare. Shoqëria është regjistruar si një person juridik sipas vendimit të Gjykatës datë 11 prill 2007, me numër NIPT-I K71627041B dhe zyra qendrore e saj është e vendosur në rrugën "Sami Frashëri", kompleksi Nobis, kati i parë, Nr. 7/630-N29, Tiranë, Shqipëri. Vendimi i Asamblesë së aksionarëve më 5 qershor 2017 aprovoi ndryshimin e statusit ligjor të Shoqërisë nga shoqëri me pronësi të kufizuar në shoqëri aksionare. Dy aksionarët e Shoqërisë janë TETE Madencilik ve Muhendislik Sanayi ve Ticaret A.S, i cili zotëron 49% të aksioneve me zyrë qendrore, Stamboll, Turqi dhe Ilbak Madencilik Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi, i cili zotëron 51% të aksioneve me zyrë qendrore, Stamboll, Turqi. Palët përfundimtare kontrolluese të Shoqërisë janë: Murat Ilbak, Mustafa Ilbak, Ahmet Hamdi Gül, Mehmet Macit Gül dhe İbrahim Cem Yalçın, Bertan Berkipnar dhe Şahin Çelik.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është nxjerrja, përpunimi, pasurimi dhe shitja me shumicë dhe pakicë, import-eksporti i cfarëdo lloj minerali (si bakri, kromi, hekuri, nikeli, zinku, qymyrguri, etj). Shoqëria është gjithastu e përfshirë në përpunimin, prerjen, shitjen me shumicë dhe pakicë, import-eksportin e cfarëdo lloj guri (si mermeri, granit, etj) deri tek përgatitja dhe shpërndarja e produkteve të përfunduara.

Shoqëria ka përfutur një leje shfrytëzimi në 20 gusht 2007 nga Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë me jetëgjatësi 20 vjet për nxjerrjen dhe përpunimin e mineralit të bakrit nga miniera ekzistuese e ndodhur në Spaç, Mirditë. Gjatë 2018, Shoqëria ka përfunduar ndërtimin e fabrikës dhe tuneleve të minierës, dhe ka filluar nxjerrjen dhe përpunimin e bakrit. Aktiviteti i shitjes ka filluar në muajin qershor 2018.

Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria kishte punonjës 190 (2018: 144 punonjës).

Operacionet e shoqërive drejtohen nga Këshilli i Administrimiti cili përbëhet nga tre anëtarë:

Z. Bertan Huseyin Berkipnar

Z.Hasan Selçuk Salman

Z. Eyup Batal

2. BAZAT E PËRGATITJES

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare bashkangjitur janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të). Ky është grupi i parë i pasqyrave vjetore financiare të Kompanisë për të cilat është aplikuar SNRF 16 "Qiratë". Ndryshimet në politikat e rëndësishme të kontabilitetit përshkruhen në Shënimin 3.17.1

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten në Albanian Lek ("Lek"), por monedha funksionale e Kompanisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019, është United States Dollar ("Usd"). Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018, monedha funksionale e Kompanisë ishte Albanian Lek ("Lek").

2. BAZAT E PËRGATITJES (vazhdim)**2.4 Parimi i vijimësisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë.

Kompania ka pësuar humbje të vazhdueshme operative për më shumë se tre vjet rresht, duke grumbulluar humbje në vlerë prej LEK 823,151,782 më 31 dhjetor 2019 (2018: LEK 385,325,173). Gjithashtu, një zhvlerësim prej 119,823,076 Lekë për aktivet afatgjata është regjistruar në vitin 2019. Manaxhimi vlerëson se Kompania do të jetë fitimprurëse duke filluar nga viti 2021 si rezultat i fillimit të prodhimit në minierën e re e cila ka më pak kosto të ekstrapolimit dhe marzh më të lartë të fitimit. Aftësia e Kompanisë për të vazhduar me parimin e vijimësisë varet nga burimet financiare të kompanisë mëmë. Kompania mëmë ka deklaruar angazhimin e saj përmes një letre mbështetëse lëshuar më 21 maj 2020, për të vazhduar mbështetjen e Kompanisë me kapital të mjaftueshëm të punës dhe financim në të ardhmen e parashikueshme. Drejtimi pranon që pasiguria mbetet mbi aftësinë e Kompanisë për të përmbushur kërkesat e saj të financimit. Sidoqoftë, Drejtimi pret që Kompania të ketë burime të përshtatshme për të vazhduar operimet e saj në të ardhmen e parashikueshme.

Kompania fitoi një licencë minerare në 20 gusht 2007 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për një periudhë 20 vjeçare për nxjerrjen dhe përpunimin e mineralit të bakrit nga miniera ekzistuese që ndodhet në Spaç, Mirditë. Me ndryshimet në strukturën aksionare gjatë vitit 2016, Shoqëria është përfshirë aktivisht në fazën e zhvillimit në lidhje me ndërtimin e fabrikës dhe minierës e cila ka filluar në mes të dhjetorit 2016.

Gjatë 2018 Shoqëria ka filluar veprimtarinë e nxjerrjes dhe prodhimit të mineraleve dhe aktiviteti i shitjes ka filluar në muajin qershor 2018. Më 15 dhjetor 2018, Kompania ka fituar dy licenca të tjera minerare nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për një periudhë 25 vjeçare për nxjerrjen dhe përpunimin e xehes së bakrit nga minierat që ndodhen në Bashkinë Mirditë, Qarku Lezhë. Në gusht 2019 kompania ka fituar edhe dy licenca të tjera minerare nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për një periudhë 25 vjeçare për nxjerrjen dhe përpunimin e mineralit të bashkëpunimit. Gjatë vitit 2019 njësia ekonomike ka përfunduar përmirësimin e fabrikës në mënyrë që të përpunojë edhe mineralin e zinkut nga katër minierat e reja. Puna nëntokësore në minierën e Koshaj, ka përfunduar brenda vitit 2019 në mënyrë që të jetë gati për procesin e nxjerrjes së mineraleve të bakrit nga minierat që ndodhen në Bashkinë Mirditë, Qarku Lezhë

Shoqëria nuk ka qëllim të likuadojë ose të ndërpresë veprimtarinë e saj gjatë vitit 2019. Drejtimi pret që Shoqëria të jetë fitimprurëse në të ardhmen dhe aftësia për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë nuk do të zhvlerësohet.

Zhvillimi i shpejtë i virusit Covid-19 dhe ndikimi i tij social dhe ekonomik në Shqipëri dhe globalisht mund të rezultojë në supozime dhe vlerësime që kërkojnë rishikime të cilat mund të çojnë në rregullime materiale të vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Në veçanti Drejtimi pret që supozimet dhe vlerësimet e përdorura në përcaktimin e Riinvestimit si aktiv dhe detyrim të ndikohen. Në këtë fazë Drejtimi nuk është në gjendje të vlerësojë në mënyrë të besueshme ndikimin pasi ngjarjet po shpalosen dita-ditës. Ndikimi afatgjatë mund të ndikojë gjithashtu në të ardhura, flukset e parave dhe përfitueshmëria. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, Tete Albania Sh.a vazhdon të përmbushë detyrimet e saj dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë bazën e përgatitjes së vazhdimësisë. Për më shume detaje referojuni notes 28, Ngjarje pas datës raportuese.

2. BAZAT E PËRGATITJES (vazhdim)

2.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet kryesore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

Informacioni në lidhje me fushat e rëndësishme për vlerësimin e pasigurisë dhe gjykimet kritike në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumën e njohur në pasqyrat financiare, përfshin:

- Zhvlerësimi, amortizimi dhe zhvlerësimi i aktiveve afatgjata (Shiko noten 2.5.1 dhe 2.5.2)
- Shtesa për zhvlerësim në rikuperueshmërinë e TVSH-së së arkëtueshme

2.5.1 Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata

Në çdo datë raportimi, drejtimi vlerëson jetëgjatësinë e dobishme të aktiveve afatgjatë dhe koston e amortizimit. Ky vlerësim bazohet në përvojën e drejtimin, praktikën e industrisë dhe karakteristikat e aktivitetit. Vlerësimet e drejtimin për jetën e dobishme të aktiveve mund të ndryshojnë ndjeshëm si rezultat i ndryshimeve në mjedisin e biznesit. Jeta e dobishme e aktiveve afatgjatë lidhet drejtpërdrejt me jetën e dobishme të minierave, e cila përcaktohet nga nivelet e rezervave të bakrit dhe zinkut brenda minierave. Për kryerjen e një vlerësimi të saktë të jetës së dobishme të minierave, drejtimi kryen studimet vjetore të matjeve gjeologjike në bashkëpunim me inxhinierët. Jeta e dobishme e vlerësuar më 31 dhjetor 2019 për minierën e Spaçit është deri në 8 vite dhe për minierën e Koshaj deri në 4 vite.

Aktivet e punimeve nëntokësore të minierave amortizohen gjatë një jete të dobishme në bazë të metodës lineare. Drejtimi konsideron që baza e metodës lineare përafron metodën e njësisë së prodhimit, sepse aktivet e Shoqërisë shfrytëzohen pothuajse plotësisht në tërë jetën ekonomike. Kërkimi i burimeve minerale është një proces i ndërlikuar i cili kërkon interpretime dhe vlerësime të besueshme në lidhje me të dhënat ekonomike dhe gjeologjike.

Rezervat e përgjithshme të identifikuara më 31 dhjetor 2019 në minierën e Spaçit vlerësohen nga ekspertët e Shoqërisë në 2,455,000 ton të 0.7% të cilësisë mesatare së bakrit dhe konsiderohen të arritshme. Rezervat e përgjithshme të bakrit dhe zinkut të identifikuara në minierën e Koshaj më 31 dhjetor 2019 janë vlerësuar në 316,472 ton të 1.1% të cilësisë mesatare të bakrit dhe 4.7% të cilësisë mesatare të zinkut.

Duke marrë të gjitha supozimet e mësipërme në konsideratë kemi konkluduar se një zhvlerësim në vlerën 119,823,076-LEK të nevojshme për t'u regjistruar në dhe për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2019. *(Ju lutemi referojuni shënimit 5)*

2. BAZAT E PËRGATITJES (vazhdim)**2.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve****2.5.2 Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata**

Siç përshkruhet në shënimin 2.4, Shoqëria ka filluar aktivitetin e nxjerrjes së mineraleve që nga viti 2018. Më 31 Dhjetor 2019 Shoqëria pësoi një humbje neto para taksave për një shumë prej 437,826,609 Lek (më 31 Dhjetor 2018: 178,214,115 Lek) dhe ka akumuluar humbje për një shumë prej 823,151,782 Lek (2018: 385,325,173 Lek).

Për këtë qëllim, më 31 dhjetor 2018, Shoqëria kreu një provë zhvlerësimi për zhvillimin e tij të aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale dhe vlerësoi shumën e rikuperueshme të tyre në 31 dhjetor 2019.

Për qëllime të testimit të zhvlerësimit, Drejtimi alokoi të gjitha pasuritë e testuara në dy njësi gjeneruese të parasë ("NGJP"), përkatësisht Spaç and Koshaj. Më 31 Dhjetor 2019, vlera kontabël e kostos së aktiveve afatgjata material dhe jo materiale, të përfshira në NGJP arritën përkatësisht 1,725,954,890 Lek dhe (2018: 1,286,042,767).

Shuma e rikuperueshme u bazua në vlerën në përdorim, të përcaktuar sipas gjykimit të rëndësishëm dhe supozimeve të përdorura, duke zbritur flukset e ardhshme të parave që do të gjenerohen nga përdorimi i vazhdueshëm i NGJP-së. Supozimet kryesore të përdorura në vlerësimin e vlerës në përdorim janë dhënë më poshtë:

Supozimet	
Çmimi i bakrit në 2020	5,200 USD
Çmimi i bakrit nga 2021 në 2026	6,000 USD
Çmimi i zinkut në 2020	2,000 USD
Çmimi i zinkut nga 2021 në 2023	2,300 USD
Norma e skontimit	12.23%

Norma e skontimit përdor një masë para tatimit bazuar në koston mesatare të ponderuar të kapitalit

Teknikat e rrjedhës së mjeteve monetare bazohen në buxhetet dhe planeve të biznesit më të fundit të aprovuara, të cilat mbështeten dhe nga jeta e minierave e planifikuar për operacionet përkatëse. Modelet e vlerësimit përdorin vlerësimet më të fundit të rezervës dhe të burimeve, supozimet përkatëse të kostos në përgjithësi bazuar në përvojën e kaluar, parashikimet e tregut të çmimeve të mallrave dhe supozimet e kursit të këmbimit.

Vlerësimi i Drejtimit bazohet në një skenar të vetëm, me vlera të prodhimit fikse dhe çmime fikse pa marrë parasysh elementë të ndryshueshëm siç janë indeksimi i çmimeve dhe kostos dhe kërkesa e bakrit dhe zinkut..

Periudha e planifikimit përfshin afatin e pritshëm të përfundimit marrëveshjes së koncesionit (shiko shënimin 2.4).

Vlerat e caktuara për supozimet kryesore paraqesin vlerësimin e drejtimit të tendencave të ardhshme në industri dhe janë bazuar në të dhënat historike nga burimet e jashtme dhe të brendshme dhe parashikimet e rrjedhës së flukseve të parase përfshijnë vlerësime për periudhën e koncesionit.

Vlerat në përdorim janë veçanërisht të ndjeshme ndaj ndryshimeve në çmimet e ardhshme të energjisë dhe kostos së ponderuar të kapitalit. Një ndryshim në çmimin e ardhshëm të bakrit dhe zinkut me + 10% / (10%) do të rezultojë në përafërsisht rritje/(rënie) të zhvlerësimit në Lek 970,736,340 (ulje çmimit me 10%) dhe 0 Lek (rritje e çmimit me 10%)..

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL**3.1 Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve të tilla dhe nga konvertimi i zërave monetarë në monedhë të huaj me kursin e fundit të vitit janë njohur në fitim dhe humbje.

Zërat jo monetarë nuk janë ri-konvertuar në fund të vitit dhe janë matur në bazë të kostos historike (konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit), përveç zërave jo-monetarë të matur me vlerën e drejtë të cilët konvertohen me kursin e datës kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Kurset zyrtare të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e raportimit janë si vijon:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
LEK / EUR	121.77	123.42
LEK / USD	108.64	107.82

3.2 Aktive afatgjata materiale**(i) Njohja dhe matja**

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar (shiko më poshtë) dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi (shih politikën kontabël 3.4).

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar. Në kostot e minierës përfshihen kostot e materialeve direkte, kostot direkte të punës, kostot e huasë të lidhura drejtpërdrejt me investimin dhe punimet në minierë si kërkimet për burime minerare dhe vlerësimi i tyre, përmirësimet e galerive etj.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta (elementët kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimi ose humbja që vjen nga pakësimi i një zëri të aktiveve afatgjata materiale përcaktohet duke krahasuar shumën e arkëtuar nga pakësimi me vlerën kontabël të zërit, dhe njihet në baza neto në të ardhurat/shpenzimet e tjera operative në fitim ose humbje.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)**3.2 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)****(iii) Zhvlerësimi**

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes sipas jetës së dobishme të aktiveve të llogaritur sipas metodës lineare. Në përcaktimin e jetës së dobishme të aktiveve, Shoqëria konsideron kufizimet ndaj përdorimit të aktiveve bazuar në kohëzgjatjen e licencës minerare prej 20 vjetësh. Jeta e dobishme e aktiveve rishikohet dhe përshtatet nëse është e nevojshme, në fund të çdo periudhe raportuese.

Përqindjet e zhvlerësimit të aplikuara në kategoritë e ndryshme të aktiveve afatgjata materiale per vitin 2019 është si vijon:

Kategoria e aktiveve afatgjata materiale	Jetëgjatësia e mbetur (vite)
Përmirësime të tokës Spaç	8
Përmirësime të tokës Koshaj	4
Ndërtesa	8
Pajisje informatike	8
Makineri dhe pajisje të tjera Spaç	8
Makineri dhe pajisje të tjera Koshaj	4
Mobilje dhe pajisje zyre	8
Automjete	8
Aktive të tjera afatgjata	8
Kosto zhvillimi miniere	8
Aktive në proces	-

Aktivitet në proces nuk janë zhvlerësuar deri në datën e raportimit të këtyre pasqyrave financiare derisa këto aktive të jenë të disponueshme për përdorim.

Pjesa më e madhe e aktiveve afatgjata materiale janë blerë gjatë vitit 2018 dhe 2019, kështu duke u bazuar në kohëzgjatjen e mbetur të licencës minerare, Shoqëria ka përcaktuar jetën e dobishme të aktiveve në 8 vite.

Gjatë vitit 2019 kompania ka regjistruar asete në progres për minierën e re, jetëgjatësia e tyre e vlerësuar do të jetë 4 vjet duke filluar nga viti 2020.

3.3 Aktivet afatgjata jo materiale

Aktivitet afatgjata jo materiale, të cilat konsistojnë tërësisht në programe, janë paraqitur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka. Amortizimi llogaritet duke përdorur metodën lineare. Shoqëria vlerëson jetëgjatësinë e mbetur të aktiveve jo-materiale në 8 vjet. Jeta e dobishme dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportimi dhe efektet e ndonjë ndryshimi në vlerësim rregjistrohen në bazë prospektive.

3.4 Zhvlerësimi**(ii) Aktive financiare jo derivative***Instrumentet financiare*

Shoqëria njihet humbje nga zhvlerësimi për HPK-te mbi aktivet financiare të matur me koston e amortizuar. Shoqëria e mat humbjet nga zhvlerësimi në një shumë të barabartë me HPK-të 12 mujore, sepse rreziku kreditor nga mosarkëtimi që pritët të ndodhi gjatë jetës së instrumentit financiar nuk është rritur në mënyrë të konsiderueshme nga njohja fillestare.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

3.4 Zhvlerësimi (vazhdim)

(i) Aktive financiare jo derivative (vazhdim)

Në përcaktimin nëse rreziku kreditor të një aktivi financiar është rritur në mënyrë të konsiderueshme nga njohja fillestare apo kur behet matja e HPK-ve, Shoqëria merr parasysh informacion të arsyeshëm dhe të bazuar që është i përshtatshëm dhe është i arritshëm pa kosto apo punë shtesë. Kjo përfshin së bashku informacionin sasior dhe cilësor dhe një analizim, bazuar në përvojën e mëparshme të Shoqërisë e informimin mbi vlerësimin e kreditimit, dhe përfshirjen e informacionit për periudhat e ardhshme.

Shoqëria supozon që rreziku kreditor për një aktiv financiar është rritur konsiderueshëm nëse arkëtimi i tij është me vonesë. Megjithatë, humbja mund të regjistrohet përpara se aktivi/të arkëtueshmet të jenë në vonesë nëse kjo mbështetet nga një informacion i arsyeshëm.

Shoqëria merr parasysh edhe faktorët mëposhtëm, për të vlerësuar nëse rreziku kreditor të një aktivi financiar është rritur konsiderueshëm:

- ndryshimet në shpërndarjen e kreditimit;
- ndryshimet aktuale ose të pritshme të normës së kredisë; ose
- kushtet që ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme aktivitetin e biznesit, flukset monetare të pritshme dhe fitimet nga klientët.

Shoqëria konsideron një aktiv financiar të mos shlyhet në kohë kur klienti ka pak mundësi të paguajë detyrimin e tij të plotë ndaj Shoqërisë, pa ndërmarrjen nga Shoqëria të veprimeve si marrja e garancisë (nëse është mbajtur ndonjë).

HPK-te 12 mujore janë pjesa e HPK-ve që rezultojnë nga ngjarjet e mundshme të mospagimit brenda 12 muajve pas datës së raportimit (ose për një periudhë më të shkurtër nëse jeta e pritshme e instrumentit është më pak se 12 muaj).

HPK-te përgjatë jetës janë HPK-te që rezultojnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të mospagimit përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

Periudha maksimale e marrë parasysh në vlerësimin e HPK-ve, është periudha maksimale kontraktuale gjatë së cilës Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut kreditor.

Matja e HPK-ve

Humbjet e pritshme të kredisë janë një vlerësim i ponderuar i probabilitetit të humbjeve të kredisë. Humbjet e kredisë janë vlera aktuale e të gjithë mungesave monetare (si diferenca mes flukseve monetare për t'ju paguar entitetit sipas kontratës dhe flukseve monetare që Shoqëria pret të arkëtojë). HPK-te janë skontuar me normën efektive të interesit të aktivitetit financiar.

Aktive financiare me kredit të zhvlerësuar

Në çdo date raportimi, Shoqëria vlerëson nëse aktivet financiare të matura me koston e amortizuar janë me kredit të zhvlerësuar. Një aktiv financiar është me 'kredit të zhvlerësuar' kur ka ndodhur një ose disa ngjarje që kanë një ndikim negativ në flukset monetare të ardhshme të përlllogaritura.

Prova që një aktiv financiar është me kredit të zhvlerësuar, përfshin të dhëna të dallueshme si më poshtë:

- vështirësi e konsiderueshme financiare e klientit;
- një shkelje e kontratës si rasti i një mospagimi;
- është e mundshme që klienti të falimentojë ose të përfshihet në riorganizime të tjera financiare; ose
- ndryshime rregulluese që do kenë një ndikim negativ në flukset monetare të debitorit.

Prezantimi i zhvlerësimit për HPK-të në pasqyrën e pozicionit financiar

Humbjet nga zhvlerësimi për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar zbriten nga vlera e kontabël bruto e aktiveve.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

3.4 Zhvlerësimi (vazhdim)

(i) Aktive financiare jo derivative (vazhdim)

Pakësimi i vlerës

Vlera kontabel bruto e një aktivi financiar regjistrohët kur Shoqëria nuk ka një pritshmëri të arsyeshme të rimarrjes së aktivitetit financiar si të plotë ose për një pjesë të tij. Për klientin e saj të vetëm, Shoqëria kryen një vlerësim mbi momentin dhe shumën e pakësimit duke u bazuar nëse ka një pritshmëri të arsyeshme të rimarrjes së tij.

(ii) Aktivitet jo-financiare

Në çdo datë raportimi, Shoqëria rishikon vlerat kontabël (neto) të aktiveve të saj jo-financiare për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Për testimin e zhvlerësimit, aktivitet grupohen në grupe të vogla aktiveve të cilat gjenerojnë flukse hyrëse monetare nga përdorimi i vazhdueshëm të cilat janë të pavarura nga flukset hyrëse monetare të aktiveve të tjera apo njësive gjeneruese të parasë.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi apo njësie gjeneruese të parasë është vlera më e lartë midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Vlera në përdorim bazohet në vlerësimin e flukseve të ardhshme monetare të skontuara në vlerën e tyre aktuale, duke përdorur një normë skontimi para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike për aktivitetin ose njësinë gjeneruese të parasë.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në qoftë se vlera kontabël e aktivitetit apo njësisë gjeneruese të parasë është më e lartë se vlera e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në fitim ose humbje.

Humbjet nga zhvlerësimi rimerren vetëm në masën sa vlera kontabël e aktivitetit nuk e tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, nëse nuk do të ishte njohur humbja nga zhvlerësimi.

3.5 Inventarët

Inventarët janë vlerësuar me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarëve llogaritet bazuar në parimin “hyrje e parë, dalje e parë” dhe përfshin koston e blerjes, kostot e shndërrimit dhe gjithë kostot e tjera për të sjellë inventarët në vendodhjen dhe në kushtet aktuale. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes përgjatë aktivitetit normal të Shoqërisë, minus kostot e vlerësuarat të përfundimit të shitjes.

3.6 Instrumentet financiarë

(i) Njohja dhe matja fillestare

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht në datën e krijimit. Të gjithë aktivitetet e tjerë financiarë dhe detyrimet e tjera financiare janë njohur fillimisht në datën në të cilën Shoqëria bëhet palë e detyrimeve kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv financiar (përveçse kur është një llogari e arkëtueshme pa një komponent të rëndësishëm financues) ose një detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejte shtuar, për një zë jo të matur me Vlerën e Drejtë Nëpërmjet Fitimit apo Humbjes (VDNFH), kostot e transaksionit që lidhen direkt me blerjen apo lëshimin e tij. Një llogari e arkëtueshme pa një komponent të rëndësishëm financues matet fillimisht me çmimin e transaksionit.

(ii) Klasifikimi dhe matja vijuese

Aktivitet financiarë –

Në njohjen fillestare, një aktiv financiar klasifikohet si i matur me: koston e amortizuar; VDATGJ – investimet në instrumentet e borxhit; VDATGJ – instrumente të kapitalit; ose VDNFH.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

3.6 Instrumentet financiarë (vazhdim)

(ii) Klasifikimi dhe matja vijuese (vazhdim)

Aktivet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes së tyre fillestare përveçse kur Shoqëria ndryshon modelin e saj të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare, e në këtë rast të gjithë aktivet financiare të prekura, riklasifikohen në ditën e parë të periudhës së parë raportuese pas ndryshimit të modelit të biznesit.

Aktivet financiare – Vlerësimi i modelit të biznesit: Politika e zbatueshme nga 1 janar 2018

Shoqëria kryen një vlerësim të objektivit të modelit të biznesit sipas të cilit mbahet një aktiv financiar. Informacioni i marrë parasysh përfshin:

- politikat dhe objektivat e specifikuar dhe zbatimi i këtyre politikave në praktikë. Këto përfshijnë nëse strategjia e drejtimit fokusohet në fitimin e të ardhurave të kontraktuara nga interesi, ruajtjen e një profili të veçantë të normës së interesit, përputhjen e kohëzgjatjes së aktiveve financiare me kohëzgjatjen e çdo detyrimi të lidhur me to ose me daljen e pritshme të flukseve monetare ose realizimin e flukseve monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve;
- rreziqet që ndikojnë në performancën e modelit të biznesit (dhe të aktiveve financiare të mbajtura brenda këtij modeli biznesi) dhe se si administrohen këto rreziqe.

Aktivet financiare – Vlerësimi nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit:

Për qëllimet e këtij vlerësimi, si ‘principal’ do të përkufizohet vlera e drejtë e aktivit financiar në njohjen fillestare. ‘Interesi’ do të përkufizohet si e ardhura për vlerën në kohë të parasë dhe me rrezikun e kreditimit lidhur me shumën e mbetur të principalit gjatë një periudhe të caktuar kohe dhe për çdo kosto apo rrezik tjetër bazik mbi huadhënien (si rreziku i likuiditetit dhe kostove administrative), si dhe një marzh fitimi.

Në vlerësimin nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa principali dhe interesi, Shoqëria merr në konsideratë kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin vlerësimin nëse aktivi financiar ka një kusht kontraktual që mund të ndryshojë kohëzgjatjen ose shumën e flukseve monetare kontraktuale në mënyrë të tillë që ky kusht nuk do të plotësohet. Në kryerjen e këtij vlerësimi, Shoqëria merr parasysh:

- ngjarje të kushtëzuara që mund të ndryshojnë shumën ose kohën e flukseve monetare;
- kushtet që mund të përshtatin normën kupon të kontraktuar, duke përfshirë opsione me normë të ndryshueshme;
- parapagimet dhe opsione zgjatje; dhe
- kushtet që kufizojnë pretendimet e Shoqërisë për flukset monetare nga aktive specifike (si p.sh. karakteristikat “pa rekurs”).

Një karakteristikë parapagimi është në përputhje me kushtin e pagesave të kryera vetëm për principal dhe interes nëse shumën e parapaguar, në thelb përfaqëson shumën të papaguar të principalit dhe interesit mbi shumën e mbetur të principalit, e cila mund të përfshijë dhe një kompensim të arsyeshëm shtesë për ndërprerje para kohe të kontratës.

Aktivet financiare matur me koston e amortizuar

Këto aktive janë matur në vijim sipas koston së amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kosto e amortizuar është zvogëluar nga humbjet nga zhvlerësimi. Të ardhurat nga interesi, fitimi apo humbja nga kurset e këmbimit dhe zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo fitim ose humbje nga çregjistrimi i aktivit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(iii) Çregjistrimi

Aktivet financiare

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar skadojnë, ose në qoftë se ajo transferon të drejtat për të arkëtuar flukset monetare kontraktuale të aktivit financiar në një transaksion në të cilin pothuajse të gjithë rreziqet dhe përfitimet e zotërimit të aktivit financiar transferohen ose në të cilin Shoqëria as nuk transferon as nuk mban të gjithë rreziqet dhe përfitimet dhe as nuk ka kontroll mbi aktivin financiar.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

3.6 Instrumentet financiarë (vazhdim)

(iii) Çregjistrimi (vazhdim)

Aktivet financiare (vazhdim)

Shoqëria futet në një transaksion kur ajo transferon aktivet të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban të gjithë ose pothuajse të gjithë rreziqet dhe përfitimet e aktivit të transferuar. Në këto raste, aktivet e transferuar nuk çregjistrohen.

Detyrimet financiare

Shoqëria e çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shlyhen, anulohen ose skadojnë. Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij modifikohen, dhe flukset monetare të detyrimit të modifikuar janë rrënjësisht të ndryshme, dhe në këtë rast njihet me vlerën e drejte, një detyrim i ri financiar bazuar mbi kushtet e ndryshuara.

Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca mes vlerës së mbetur dhe pagesës së kryer (duke përfshirë çdo aktiv jo monetar të transferuar apo detyrimi të marra përsipër) njihet në fitim apo humbje.

(ii) Kompensimi

Aktivet financiare dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm atëherë, kur Shoqëria ka aktualisht një të drejtë ligjore për të kompensuar vlerat dhe synon ose të shlyejë në bazë neto ose të përfitojë aktivin dhe shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

3.7 Kapitali aksionar

Kapitali aksionar përbëhet nga kontributet në para të themeluesve të Shoqërisë. Kapitali aksionar mbahet në monedhën vendase LEK, i konvertuar nga monedha e huaj, duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Kapitali aksionar i Shoqërisë është njohur me vlerën nominale.

3.8 Njohja e të ardhurave

Njohja e të ardhurave sipas SNRF 15 (e zbatueshme nga 1 janar 2018)

E ardhura nga shitja e mallrave lidhet me shitjen e mallrave me një çmim të caktuar. Detyrimi është që të shpërndahet një seri mallrash të dallueshme dhe çmimi i transaksionit është shuma që Shoqëria pret të marrë, qoftë me çmimin e shitjes në atë moment ose me çmimin e kontratës. Detyrimi realizohet në kohë, kështu që e ardhura njihet për çdo njësi të shitur me çmimin e transaksionit.

Shoqëria njeh të ardhurat kur plotëson (ose në masën që plotëson) kushtin e performancës duke transferuar mallin e premtuar (bakër) tek një klient. Një aktiv konsiderohet i transferuar nëse (ose në masën që) klienti kontrollon atë aktiv.

Të ardhurat e përlogaritura

Drejtimi llogarit të ardhurat në lidhje me produktin e dërguar bazuar në kushtet e kontratës, por nuk i ka faturuar klientit shumën përfundimtare të transaksionit në datën e raportimit. Të ardhurat e tilla bazohen në specifikimet historike të produkteve dhe vlerësimin e ardhshëm të Tregut të këmbimit në Londër të çmimit. Detajet mbi të ardhurat e llogaritura gjenden në shënimin 10.

3.9 Kostot e huamarrjes

Kostot e huamarrjes të cilat i atribuohen drejtpërsëdrejti blerjes, ndërtimit ose prodhimit të një aktivi të kualifikuar janë ato kosto të huamarrjes që do të ishin shmangur nëse shpenzimet për aktivin e kualifikuar nuk do të ishin bërë. Kur një njësi ekonomike huazon fonde në mënyrë specifike me qëllim të marrjes së një aktivi të caktuar të kualifikuar, kostot e huamarrjes që lidhen drejtpërdrejt me atë aktiv të kualifikuar mund të identifikohen lehtësisht.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

3.9 Kostot e huamarrjes (vazhdim)

Në masën që një njësi ekonomike huazon fonde në mënyrë specifike me qëllim të marrjes së një aktivi të kualifikuar, njësia ekonomike duhet të përcaktojë shumën e kostove të huamarrjes të pranueshme për kapitalizim, si shpenzimet aktuale të huamarrjes të bëra për atë huamarrje gjatë periudhës, minus çdo të ardhur nga investimi në investimin e përkohshëm e atyre huave. Në masën që një njësi ekonomike huazon fondet në përgjithësi dhe i përdor ato për qëllim të marrjes së një aktivi të kualifikuar, njësia ekonomike duhet të përcaktojë shumën e kostove të huamarrjes të pranueshme për kapitalizim duke aplikuar një normë të kapitalizimit në shpenzimet për atë aktiv.

Shkalla e kapitalizimit është mesatarja e ponderuar e kostove të huamarrjes të zbatueshme për huamarrjet e njësisë ekonomike që janë të papaguara gjatë periudhës, përveç huave të marra në mënyrë specifike me qëllim të marrjes së një aktivi të kualifikuar. Shuma e kostove të huamarrjes që një njësi ekonomike kapitalizon gjatë një periudhe nuk duhet të tejkalojë shumën e kostove të huamarrjes që ka ndodhur gjatë asaj periudhe.

3.10 Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Qeveria Shqiptare është përgjegjëse për përcaktimin e limitit ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

3.11 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat nga fondet në banka, të ardhura nga efekti i kursit të këmbimit nga detyrimet ndaj aksionarëve dhe nga huaja bankare. E ardhura nga interesi njihet kur ai përfitohet, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huamarrjet.

Kostot e huasë që nuk lidhen direkt me blerjen, ndërtimin apo prodhimin e një aktivi që kualifikohet për kapitalizimin e këtyre kostove, njihen direkt në rezultat duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit prezantohen neto si e ardhur ose shpenzim financiar në varësi nëse lëvizjet në kursin e këmbimit janë në një ekspozim neto fitimi apo humbje.

3.12 Tatimi mbi fitimin i periudhës dhe i shtyrë

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale dhe ai i shtyrë njihen në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose të ardhura të tjera përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet ose të arkëtohet mbi fitimin apo humbjen e tatueshme të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që hyn në fuqi menjëherë në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është njohur për diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Tatimi i shtyrë është matur duke përdorur normën tatimore që pritet të aplikohet ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen, bazuar në ligjet në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e raportimit. Aktivitetet dhe pasivitetet tatimore të shtyra netohen nëse ekziston një e drejtë ligjore për të netuar detyrimet për tatimin aktual të pagueshëm ndaj tatimit të parapaguar, dhe ato lidhen me tatimin mbi të ardhurat që përcakton i njëjti autoritet tatimor. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për humbjet fiskale të papërdorura, kreditime tatimore dhe diferenca të përkohshme të zbritshme për atë që është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ato të mund të përdoren.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

3.12 Tatimi mbi fitimin i periudhës dhe i shtyrë (vazhdim)

Aktivi tatimor i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet për aq sa nuk është e mundur të realizohet përfitim fiskal.

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe tatimit të shtyrë. Shoqëria merr në konsideratë ndikimin e një pozicioni tatimor të paqartë dhe tatimet dhe interesat shtesë që mund të lindin. Shoqëria beson se përlllogaritja e detyrimeve tatimore është e saktë për të gjitha periudhat e tatueshme bazuar në vlerësimin e disa faktorëve, duke përfshirë interpretimin e legjislacionit tatimor dhe ekperiencën e mëparshme. Kjo përlllogaritje mbështetet në vlerësime dhe supozime si dhe mund të përshijë një sërë gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme. Në rast se si rrjedhojë e disponimit të një informacioni, gjykimi i Shoqërisë për mjaftueshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese ndryshon, ky ndryshim do të reflektohet në shpenzimin tatimor të periudhës kur ai përcaktohet.

3.13 Provigjonet

Provigjonet njihen kur si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Shoqërisë i lindin detyrime (ligjore ose konstruktive) të cilat mund të parashikohen me besueshmëri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit. Nëse efekti është material, provigjonet janë përcaktuar duke ju zbritur vlerën e pritshme të rrjedhës së mjeteve monetare të skontuara me një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimeve. Provigjonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më mundësi që një rrjedhje burimesh që përfshin përfitime ekonomike për shlyerjen e detyrimit, të jetë e nevojshme për mbylljen e detyrimit, provigjonet rimerren. Provigjonet përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë njohur fillimisht. Nuk njihet provigjon për humbjet e ardhshme operative.

3.14 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare të veçanta. Për një detyrim të kushtëzuar jepet informacion shpjegues vetëm kur mundësia e një daljeje burimesh që përfshin përfitime ekonomike nuk ekziston më. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare të veçanta por jepet informacion shpjegues kur realizimi i të ardhurave është i mundur. Shuma e humbjes së kushtëzuar njihet si provigjon nëse është e mundur që ngjarje të ardhshme ta konfirmojnë atë, një detyrim që ka lindur deri më datën e raportimit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i humbjes.

3.15 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarët dhe drejtimi i Shoqërisë, së bashku me entitetet që kontrollojnë, të cilët kanë një ndikim të rëndësishëm mbi aktivitetin dhe drejtimin e Shoqërisë. Në marrjen në konsideratë të çdo marëdhënie të mundshme me palët e lidhura, vëmendja i drejtohet thelbit të marëdhënies, jo vetëm formës ligjore.

3.16 Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së raportimit që ofrojnë informacion shtesë në lidhje me pozicionin financiar të Shoqërisë në datën e raportimit (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së raportimit që nuk janë ngjarje rregulluese janë paraqitur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të veçanta nëse janë material.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

3.17 APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA (SNRF)

3.17.1 Standardet dhe Interpretime efektive në periudhën aktuale

Ndryshimet në standardet ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, dhe interpretimet e miratuara nga Komiteti Ndërkombëtarë i Interpretimeve të Raportimeve Financiare, janë efektive për periudhën aktuale:

- **SNRF 16, Qiratë** (publikuar më 13 janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).

Shoqëria ka aplikuar SNRF 16 – Qirate për herë të parë nga 1 janari 2019. Një numër standardesh të tjera të reja janë gjithashtu efektive nga 1 janari 2019, por ato nuk kanë një efekt material në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike.

Kompania aplikoi SNRF 16 duke përdorur qasjen e modifikuar retrospektive, duke përdorur metodën praktike dhe duke zëvendësuar të gjitha kërkesat e standardit të mëparshëm SNK17. Detajet e ndryshimeve në politikat e kontabilitetit janë shpalosur më poshtë.

A. Përcaktimi i qirasë

Me parë, Shoqëria përcaktonte në fillim të kontratës nëse një marrëveshje ishte ose përmbante një qira nën KIRFN 4 - Përcaktimi nëse një Marrëveshje është marrëveshje Qiraje. Kompania tani vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira bazuar në përkufizimin e qirasë, siç shpjegohet në shënimin 6.

Shoqëria zbatoi SNRF 16 vetëm për kontratat që më parë ishin identifikuar si qiratë. Kontratat të cilat nuk ishin identifikuar si qiranë sipas SNK 17 dhe KIRFN 4 nuk u rivlerësuan nëse ekziston një qira sipas SNRF 16. Prandaj, përkufizimi i qirasë sipas SNRF 16 u zbatua vetëm për kontratat e lidhura ose ndryshuar në ose pas 1 janarit 2019.

B. Si qiramarrës

Si qiramarrës, Shoqëria merr me qira ambiente zyre, magazina dhe automjete. Shoqëria më parë ka klasifikuar qiratë si qira operative ose financiare bazuar në vlerësimin e saj nëse qiraja transferon në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e rastësishme në pronësi të aktivitetit themelor në kompani. Sipas SNRF 16, Shoqëria njeh të drjetën për përdorimin e aktiveve dhe detyrimet e qiradhënies për shumicën e këtyre qirave - d.m.th. këto qira janë pjesë e bilancit.

Me fillimin ose me modifikimin e një kontrate që përmban një komponent të qirasë, Shoqëria shpërndan vlerësimin në kontratë për secilin përbërës të qirasë në bazë të cmimeve specifike të shitjes të shoqërisë.

Megjithatë, për qiratë e pasurive, shoqëria ka zgjedhur të mos ndajë përbërësit jo-qira dhe të regjistrojë komponentët e qirasë dhe jo- qirasë si një komponent i vetëm i qirasë.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)**3.17 APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA (SNRF)****3.17.1 Standardet dhe Interpretimet efektive në periudhën aktuale (vazhdim)****C. Qiradhëniet e klasifikuara si qira operative nën SNK 17**

Më parë, Shoqëria i klasifikonte qiratë e pasurive si qira operative nën SNK 17. Me aplikimin e SNRF 16, detyrimet e qirasë u matën me vlerën aktuale të pagesave të mbetura të qirasë, të skontuara me normën rritëse të huamarrjes të kompanisë më 1 janar 2019. Aktivet me të drejtë përdorimi maten ose me:

— vlerën kontabël të tyre sikur SNRF 16 të ishte aplikuar që nga data e fillimit, skontuar me normën rritëse të huamarrjes të kompanisë në datën e aplikimit fillestar: Shoqëria aplikoi këtë qasje për qiratë më të mëdha të shoqërisë. ose

— një shumë e barabartë me detyrimin e qirasë, rregulluar nga shuma e çdo pagese të parapaguar ose të llogaritur të qirasë: Shoqëria zbatoi këtë qasje në të gjitha qiratë e tjera.

SNRF 16, Qiratë**D. Ndikimi në pasqyrat financiare****a. Ndikimi në tranzicion**

Shoqëria ka aplikuar për here të parë SNRF 16 në 1 janar 2019 me qasjen e modifikuar retrospektive, për kontratat aftagjata të qirasë për zyrat dhe token Me kalimin në SNRF 16, shoqëria njohu aktive të së drejtës së përdorimit, përfshirë aktivet afatgjata të investuara, dhe detyrime të qirasë. Ndikimi i aplikimit të SNRF 16 është përmbledhur më poshtë.

Në mijë Lek	31 Dhjetor 2019
Aktive me të drejtë përdorimi – Zyra	5,949,195
Aktive me të drejtë përdorimi – Toka	20,805,376
Detyrimet e qirasë	18,367,550

Shumat e njohura në fitim ose humbje 2019 - Qira nën SNRF 16	In Lek
Tarifa e zhvlerësimit për aktivet e përdorimit të së drejtës (shiko shënimin 7)	(6,197,565)
Kamata për detyrimet e qirasë	(997,813)
2019 - Qiratë operative sipas SNK 17	
Shpenzimet e qirasë (shiko shënimin 20)	11,524,381

b. Qiratë**Politika e zbatueshme nga 1 janari 2019**

Në fillimin e një kontrate, Shoqëria vlerëson nëse një kontratë është, ose përmban, një qira. Një kontratë është, ose përmban, një qira nëse kontrata përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar për një periudhë kohe. Për të vlerësuar nëse një kontratë përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar, Shoqëria përdor përkufizimin e qirasë në SNRF 16. Kjo politikë zbatohet për kontratat e lidhura, në ose pas 1 janarit 2019.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

3.17 APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA (SNRF)

3.17.1 Standardet dhe Interpretime efektive në periudhën aktuale (vazhdim)

D.Ndikimi në pasqyrat financiare (vazhdim)

Si qiramarrës

Me fillimin ose me modifikimin e një kontrate që përmban një komponent të qirasë, Shoqëria shpërndan vlerësimin në kontratë për secilin përbërës të qirasë në bazë të cmimeve specifike të shitjes të shoqërisë. Megjithatë, për qiratë e pasurive, shoqëria ka zgjedhur të mos ndajë përbërësit jo-qira dhe të regjistrojë komponentët e qirasë dhe jo- qirasë si një komponent i vetëm i qirasë.

Shoqëria njeh një aktiv me të drejtë përdorimi dhe një detyrim të qirasë në datën e fillimit të qirasë. Aktiv i me të drejtë përdorimi fillimisht matet me koston, e cila përfshin shumën fillestare të detyrimit të qirasë të rregulluar për çdo pagesa të qirasë të bërë në ose para datës së fillimit, plus çdo kosto fillestare direkte të ndodhur dhe një vlerësim të kostove për çmontimin dhe heqjen e aktivin bazë ose për të rivendosur aktivin bazë në kushtet e kërkuara, minus çdo stimul qiraje të marrë.

Aktiv i me të drejtë përdorimi zhvlerësohet më pas duke përdorur metodën e lineare nga data e fillimit deri në fund të afatit të qirasë, përveç nëse qiraja transferon pronësinë e aktivit bazë tek Shoqëria deri në fund të afatit të qirasë ose kostoja e aktivit të së drejtës së përdorimit pasqyron që Shoqëria do të ushtrojë një opsion blerjeje. Në këtë rast, aktiv i të drejtës së përdorimit do të zhvlerësohet gjatë jetës së dobishme të aktivit bazë, i cili përcaktohet në të njëjtën bazë si ato të pasurive dhe pajisjeve. Për më tepër, aktiv i me të drejtë përdorimi zvogëlohet në mënyrë periodike nga humbjet e zhvlerësimit, nëse ka, dhe rregullohet për rivlerësime të caktuara të detyrimit të qirasë.

Detyrimi i qirasë fillimisht matet me vlerën aktuale të pagesave të qirasë, të cilat nuk janë paguar në datën e fillimit, skontuar me normën e interesit të nënkuptuar në qira ose, nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet me lehtësi, norma rritëse e huamarrjes së kompanisë. Në përgjithësi, Shoqëria përdor normën e saj të huamarrjes si norma e skontimit.

Shoqëria përcakton normën rritëse të huamarrjes duke marrë norma interesi nga burime të ndryshme të financimit të jashtëm dhe bën rregullime të caktuara për të pasqyruar kushtet e qirasë dhe llojin e aktivit të marrë me qira.

Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përfshijnë pagesat për të drejtën e përdorimit të aktivit bazë gjatë afatit të qirasë, të papaguara në datën e fillimit si më poshtë:

- pagesat fikse përfshirë pagesat fikse në-thelb;
- pagesat variabël të qirasë të cilat varen nga një indeks ose normë, e matur fillimisht duke përdorur një indeks ose normë në datën e fillimit;
- shumat që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur; dhe
- çmimi i ushtrimit të një opsioni blerjeje nëse qiramarrësi është mjaft i sigurt për ta ushtruar këtë opsion, pagesa të qirasë në një periudhë rinovimi opsionale nëse Shoqëria është e sigurt për të ushtruar një mundësi shtesë, dhe gjoba për përfundimin e parakohshëm të qirasë, përveç nëse Shoqëria është me siguri të arsyeshme që të mos e ndërpresë herët.

Detyrimi i qirasë matet me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Rivlerësohet kur ka një ndryshim në pagesat e ardhshme të qirasë që vijnë nga një ndryshim në një indeks ose normë, nëse ka një ndryshim në vlerësimin e Shoqërisë për shumën që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur, nëse Shoqëria ndryshon vlerësimin e saj nëse ajo do të ushtrojë një mundësi blerjeje, zgjatjeje ose përfundimi ose nëse ka një pagesë të rishikuar të qirasë fikse në-thelb.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

3.17 APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA (SNRF) (VAZHDIM)

3.17.1 Standardet dhe Interpretime efektive në periudhën aktuale (vazhdim)

D. Ndikimi në pasqyrat financiare (vazhdim)

Si qiramarrës

Kur detyrimi i qirasë është ri-matur në këtë mënyrë, bëhet një rregullim përkatës në vlerën kontabël të aktivitetit të së drejtës së përdorimit, ose regjistrohet në fitim ose humbje nëse vlera kontabël e aktivitetit të së drejtës së përdorimit është zvogëluar në zero.

Qiratë afatshkurtra dhe qiratë e pasurive me vlerë të ulët

Shoqëria ka zgjedhur të mos njohë aktivet me të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë për qira të aktiveve me vlerë të ulët dhe qira afatshkurtra, përfshirë pajisjet IT. Shoqëria njeh pagesat e qirasë që lidhen me këto qira si një shpenzim në bazë lineare për periudhën e qirasë.

Politika e zbatueshme para 1 janarit 2019

i. Si qiramarrës

Në periudhën krahasuese, si qiramarrëse, Shoqëria klasifikoi qiratë që transferojnë në mënyrë të konsiderueshme të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë si qira financiare. Nëse ky ishte rasti, aktivet e marra me qira u matën fillimisht në një shumë të barabartë me vlerën e tyre të drejtë dhe vlerën aktuale të pagesave minimale të qirasë. Pagesat minimale të qirasë ishin pagesa për afatin e qirasë që qiramarrësit i kërkohej të bënte, duke përjashtuar çdo qira të kushtëzuar. Pas njohjes fillestare, aktivet u llogaritën në përputhje me politikën e kontabilitetit të zbatueshme për atë aktiv.

Pasuritë e mbajtura nën qiratë e tjera janë klasifikuar si qira operative dhe nuk janë njohur në pasqyrën e pozicionit financiar të Kompanisë. Pagesat e bëra nën qiradhëniet operative u njohën në fitim ose humbje në bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Stimujt e marrë të qirasë u njohën si pjesë përbërëse e shpenzimeve totale të qirasë, gjatë afatit të qirasë.

- **Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentat Financiarë"** – Veçoritë e Parapagimit me Kompensim Negativ (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2019),
- **Ndryshimet në SNK 19 "Përfitimet e punonjësve"** - Ndryshimi i planit, shkurtimi ose shlyerja (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019),
- **Ndryshimet në SNK 28 "Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta"** - Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2019),
- **Ndryshimet në standarde të ndryshme për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2015-2017)"** që rezultojnë nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe qartësimin e formulimit efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019)
- **IFRIC 23 "Pasiguria mbi trajtimet e tatimit mbi të ardhurat"** (efektive për periudhat vjetore duke filluar nga ose pas 1 Janarit 2019)

Zbatimi i këtyre ndryshimeve në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim në pasqyrat financiare të Shoqërisë, përveç SNRF 16 impakti i të cilës në Pasqyrat Financiare është përmendur më lart.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)

3.17 APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA (SNRF) (VAZHDIM)

3.17.2 Standarde dhe interpretime në publikim akoma jo në fuqi

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet, rishikimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin në diskutim, por ende jo efektive:

- **SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit"** (efektiv më ose pas datës 1 Janar 2021),
- **Ndryshimet në SNRF 3 "Kombinimet e Biznesit"** - Përkufizimi i një Biznesi (efektiv për kombinime biznesi për të cilat data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë vjetore të raportimit që fillon më ose pas 1 janarit 2020 dhe për blerjet e aktiveve që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe)
- **Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet Financiarë", SNK 39 "Instrumentet Financiarë: Njohja dhe Matja" dhe SNRF 7 "Instrumentet Financiarë: Shpalosjet"** - Reforma e Standardit të Normave të Interesit (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2020),
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta"** - Shitja apo Kontributi i aseteve mes një Investitori dhe bashkëpunëtorëve të tij, ose sipërmarrje të përbashkëta dhe ndryshimeve të mëtejshme (data efektive e shtyrë për kohë të pacaktuar derisa projekti kërkimor mbi metodën e kapitalit neto të jetë përfunduar),
- **Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare" dhe SNK 8 "Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet"** - Përkufizimi i Materialit (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020),
- **Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare"** - Klasifikimi i Detyrimeve si aktuale ose jo-aktuale (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2022)
- **Ndryshimet në Referencat në Kuadrin Konceptual në Standardet e SNRF** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020),

Kompania ka zgjedhur të mos miratojë këto standarde të reja, ndryshime në standardet ekzistuese dhe interpretime të reja përpara datës kur ato të hyjnë në fuqi. Kompania parashikon që miratimi i standardeve të tjera, rishikimet dhe interpretimet, nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar.

4. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR**(a) Faktorët e rrezikut financiar**

Aktiviteti i Shoqërisë e ekspozon atë ndaj disa rreziqesh financiare, duke përfshirë rrezikun e kredisë, rrezikun nga kurset e këmbimit dhe rrezikun e normave të interesit. Administrimi i rrezikut të Shoqërisë përqëndrohet në paparashikueshmërinë e tregut dhe kërkon të minimizojë efektet e mundshme negative mbi performancën e biznesit të Shoqërisë.

(b) Rreziku i likuiditetit

Ekziston rreziku që mjetet monetare mund të mos jenë të disponueshme për të shlyer detyrimet në kohën e duhur me një kosto të arsyeshme. Shoqëria monitoron likuiditetin e saj periodikisht në mënyrë që të administrojë detyrimet e saj kur nevojitet.

Më 31 dhjetor 2019 dhe 2018, struktura e maturitetit të detyrimeve financiare të Shoqërisë në bazë të pagesave të aktualizuara është paraqitur më poshtë:

	Më pak se 6 muaj	6 - 12 muaj	Mbi 12 muaj	Totali
Llogari të pagueshme tregtare	368,931,842	96,524,467	21,545,501	487,001,810
Detyrime të tjera	31,976,749	-	-	31,976,749
Huatë	366,123,535	495,569,725	1,670,714,466	2,532,407,726
Detyrime për qiratë financiare	57,818,372	57,818,373	99,830,377	215,467,122
Më 31 dhjetor 2019	824,850,498	649,912,565	1,792,090,344	3,266,853,407

	Më pak se 6 muaj	6 - 12 muaj	Mbi 12 muaj	Totali
Llogari të pagueshme tregtare	250,105,599	18,798,711	17,280,932	286,185,242
Detyrime të tjera	27,955,991	-	-	27,955,991
Huatë	156,522,179	123,311,788	1,362,458,588	1,642,292,555
Detyrime për qiratë financiare	8,525,086	9,219,280	30,212,100	47,956,466
Më 31 dhjetor 2018	443,108,855	151,329,779	1,409,951,620	2,004,390,254

c) Rreziku kreditor

Ekziston një rrezik kreditor në momentin që palët nuk arrijnë të përmbushin detyrimet e tyre kontraktuale lidhur me pagesat e llogarive të arkëtueshme dhe aktiveve të tjera.

Shoqëria vlerëson cilësinë e të arkëtueshmeve të cilat nuk janë as në vonesë as të zhvlerësuar. Më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 vlera e mbetur e aktiveve financiare që përfaqëson maksimumin e ekspozimit të rrezikut kreditor është zero.

4. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**(d) Rreziku i kurseve të këmbimit**

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit që vjen prej ekspozimit ndaj monedhave të huaja, kryesisht ndaj monedhës së Euros. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument për t'u mbrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit. Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të mbajtur një pozicion të përshtatshëm neto në çdo monedhë dhe në total si dhe të monitoroj operacionet me bazë ditore.

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 ishte si më poshtë:

	Vlera e mbetur	USD	EUR	LEK
Më 31 dhjetor 2019				
<i>Aktive financiare</i>				
Të ardhura të përlllogaritura	111,559,120	111,559,120	-	-
Aktive të tjera	28,897,780	6,116,022	1,741,817	21,039,941
Parapagime për aksionerët	5,256,450	5,256,451	-	-
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	16,587,828	6,790,433	4,533,736	5,263,659
Totali	162,301,178	129,722,025	6,275,553	26,303,600
<i>Detyrime financiare</i>				
Llogari të pagueshme tregatre	(487,001,810)	(179,055,054)	(87,326,627)	(220,620,129)
Detyrime të tjera	(31,976,749)	-	-	(31,976,749)
Huatë	(2,532,407,726)	(2,510,323,587)	(22,084,139)	-
Detyrime për qiratë financiare	(215,467,122)	(129,010,326)	(70,483,513)	(15,973,283)
Totali	(3,266,853,407)	(2,818,388,967)	(179,894,279)	(268,570,161)
